**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

**TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 63 Datë 29.08.2025**

## VERIFIKIM SI REZULTAT I INDICIEVE NGA ORGANET AUDITUESE DHE MONITORIM I ZBATIMIT TË KONTRATËS

| | |
|---|---|
| **Autoriteti kontraktor** | **SHOQËRIA SHTETËRORE "IDENTITEK" SH.A** |
| **Organi auditues** | **DREJTORIA E AUDITIMIT NË MINISTRINË E BRENDSHME** |
| **Numri i procedurave të audituara** | 11 (njëmbëdhjetë) |
| **Numri i kontratave të audituara** | 11 (njëmbëdhjetë) |
| **Lloji i procedurave të audituara** | "Procedurë e Hapur": 5 (pesë)<br>"Procedurë e Hapur e Thjeshtuar": 4 (katër)<br>"Procedurë prokurimi me vlerë të vogël": 2 (dy) |
| **Tipi i kontratës** | "Kontratë publike furnizimi": 6 (gjashtë)<br>"Kontratë publike për shërbime": 5 (pesë) |
| **Konstatimet kryesore** | 1. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 34, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me përllogaritjen e vlerës së prokurimit, në procedura prokurimi të audituara.<br><br>2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 78 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, lidhur me argumentimin e specifikimeve teknike, në procedura prokurimi të audituara.<br><br>3. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me nenin 92, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, lidhur me procesin e vlerësimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në procedura prokurimi të audituara.<br><br>4. APP vlerëson se autoriteti kontraktor, nuk ka dëshmuar se kontrata dëshmuar se kontrata është zbatuar sipas kushteve të prokuruar dhe detyrimeve të kontratës, sipas parashikimeve të nenit 124, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Gjithashtu, Autoriteti kontraktor nuk ka provuar se ka administruar dokumentacionin e plotë që lidhet me mallin, që garanton se produkti i lëvruar është sipas specifikimeve teknike të parashikuara në kontratë dhe dokumentet e tenderit. |
| **Masat e marra** | Në bazë të neneve 23/e dhe 132, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 23 (njëzet e tre) personave, të evidentuar përgjegjës për mangësi të konstatuara në vendim. |